



UNMIK



IPVQ

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti i Ministrit

Cabinet of the Minister

Kabinet Ministra

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Vlerësimi profesional i fëmijëve me nevoja të veçanta

NUMËR:9/2007

DATË: 5.04.2007

Në bazë të nenit 1.3 pika (d) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, nenit 25.7 të Rregullores së punës së Qeverisë së Kosovës nr.1/2007, si dhe në bazë të nenit 1 (d), (v), 2.1, 15.1, 22, 23, 35, 36, 37, 39 e 40 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm të Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) nxjerr këtë Udhëzim Administrativ :

Neni 1

Qëllimi

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim që të përcaktoj procedurën me të cilën bëhet vlerësimi profesional i fëmijëve me nevoja të veçanta në mënyrë që atyre të ju afrohet një arsimim i përshtatshëm për t'i përmbushur nevojat e tyre të përcaktuara nga MASHT-i.

Neni 2

Vlerësimi profesional

Vlerësimi profesional i fëmijëve me nevoja të veçanta mund të përfshijë:

- a) Institucionet e edukimit parashkollor,
- b) Klasat e rregullta (në të gjitha nivelet e shkollimit),
- c) Klasat e bashkangjitura pranë shkollave të rregullta,
- d) Shkollat speciale si qendra burimore të resurseve profesionale të arsimit special,
- e) Shkollat speciale të tipit spitalor,
- f) Qendrat edukative e rehabilituese.

Neni 3

Përcaktimi i nevojave të fëmijëve me procedure paraprake të vlerësimit

1. Inicimin e kërkesës për vlerësimin e fëmijës që do të përfshihet në kornizën arsimore sipas qëllimit të përcaktuar nga nevojat e veçanta të tij, mund ta parashtrij:

- a) Nxënësi;
- b) Prindi apo kujdestari ligjor i fëmijës;
- c) Drejtori i shkollës ku është i regjistruar fëmija;
- d) Drejtori i arsimit komunal për komunën ku është i regjistruar fëmija;
- e) Mjeku i kujdesit familjar apo ndonjë specialist tjetër mjekësor;
- f) Drejtori i Qendrës komunale për Punë Sociale.
- g) Të tjerët të cilët me kërkesë i drejtohen Komisionit për vlerësim të FNV.

2. Kur në vend të njërit ose të dy prindërve apo kujdestarit ligjor, një shërbim tjetër kërkon që të bëhet vlerësimi, kryesuesi i Komisionit vlerësues duhet t'i informoj prindërit/kujdestarin ligjor dhe të kërkoj leje me shkrim prej tyre për të vazhduar procedurën e vlerësimit. Në rastet kur prindërit nuk jetojnë së bashku apo janë shkurorëzuar, nënshkrimi i njërit prind është i mjaftueshëm për të pranuar kërkesën, përderisa edhe prindi tjetër është i informuar për këtë kërkesë.

Neni 4

Komisioni i vlerësimit

1. Vlerësimin e fëmijës do ta bëjnë pjestarët e Komisioneve të cilët do të përcaktohen nga Sekretari i Përhershëm i MASHT-it në konsultim me Sekretarin e Përhershëm të MPMS dhe MSH

2. Komisioni vlerësues do të jetë i përbërë prej 11 anëtarëve si në vijim:

2.1. Anëtarët e përhershëm:

- a) Eksperti i arsimit special nga MASHT (kryesues);
- b) Drejtori komunal i arsimit.
- c) Një psikolog i licencuar i fëmijëve apo psikolog shkollor;
- d) Një përfaqësues i propozuar nga Komiteti i Prindërve i Arsimit të Kosovës (KPAK).

2.2. Anëtarët e përkohshëm, të emëruar varësisht nga nevojat e veçanta që supozohet t'i ketë fëmija:

- a) Punëtori social;
- b) Psikiatri;
- c) Defektologu (Logopedi, Surdoaudiologu, Oligofrenologu, Tiflologu);
- d) Fiziatri.;

3. Drejtori i shkollës që e referon nxënësin për vlerësim apo ndonjë përfaqësues i tij, duhet të jetë prezent në të gjitha takimet e Komisionit lidhur me atë fëmijë. Nëse

fëmija nuk vijon shkollimin, personi apo institucioni që e ka dërguar fëmijën, duhet të jetë prezent në të gjitha seancat vlerësuese.

4. Edhe personat në vijim mund të marrin pjesë në procedurën vlerësuese nëse dëshirojnë:

- a) Prindi i fëmijës;
- b) Mësuesi i fëmijës;
- c) Ndonjë i afërm tjetër (por me kusht që së paku njëri prind pajtohet);
- d) Avokati apo ndonjë profesionist tjetër i autorizuar nëse këtë e kërkojnë prindërit.

5. Personat nga paragrafet 3 dhe 4 të nenit 4 nuk kanë të drejtë vote dhe janë vetëm konsultativ.

Neni 5

Fuqitë administrative të Komisionit për Vlerësim

1. Vendimet e komisionit të vlerësimit të cilat janë të plotfuqishme duhet të zbatohen si nga personat që ju drejtohen ashtu edhe nga institucionet dhe ndërmarrjet .

2. Personat e pakënaqur me vendimet e Komisionit për vlerësim mund të parashetrojnë ankesë praën Komisionit për Parashtrësia dhe Ankesa në MASHT në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së vendimit.

3. Komisioni i vlerësimit ka të drejtë të kërkoj dokumentet e nevojshme për të kompletuar një vlerësim sa më objektiv dhe të plotë për fëmijën. Kërkimi i dokumenteve të tilla ka fuqinë e një urdhëri sikur nga gjykata. Gjithsesi, përgjegjësia për të zbatuar këtë urdhër bie mbi prindërit që duhet të sjellin fëmijën dhe mbi profesionistin që do të bëjë vlerësimin dhe do të plotësojë dokumentacionin.

4. Komisioni i vlerësimit ka kompetencë që të:

- a) Vendos për afrimin e shërbimeve speciale brenda kornizës së arsimit të rregullt siç janë: korigjimi i të folurit, orë shtesë për mësimdhënie, fizioterapi, terapi të gjuhës, udhëzime të specializuara, ndihmë mjekësore për fëmijët sipas dëmtimeve dhe të tjera.
- b) Vendos për vendosjen e fëmijës në klasë të bashkangjitur, shkollë speciale apo vendin më të përshtatshëm për akomodimin e fëmijëve me nevoja të veqanta (FNV).
- c) Gjatë marrjes së vendimit për shërbime speciale, komisioni i vlerësimit do të merr parasysh edhe vështirësitë financiare dhe kufizimet buxhetore. Komisioni gjithnjë do të udhëhiqet nga arsyeja maksimale në zgjidhjen e kërkesave të FNV në plotësimin dhe afrimin e shërbimeve rreth arsimit special duke përcaktuar nevojat e përdorimit të mjeteve ndihmëse ortopedike dhe veglave tjera të nevojshme.

Neni 6

Procedura për afrimin e shërbimeve rreth vlerësimit të nevojave për arsimim special

- 1.** Gjatë periudhës së ardhshme dyvjeçare, procedura e vlerësimit profesional të fëmijëve me nevoja të veçanta do të jetë më fleksibile, në mënyrë që t'iu mundësohet këtyre fëmijëve çasja sa më e shpejtë që është e mundur në shfrytëzimin e shërbimeve të nevojshme. Procedura për përcaktimin e shërbimeve, në të ardhmen do të planifikohet në atë mënyrë që shërbimet e identifikuara si të domosdoshme, do të planifikohen në fillim të vitit shkollor.
- 2.** Kërkesat për vlerësim do t'i dërgohen kryesuesit të Komisionit vlerësues.
- 3.** Në afatin prej 15 ditësh nga koha e marrjes së kërkesës për vlerësim, kryesuesi do të caktojë një takim parapërgatitor me anëtarët e përhershëm të Komisionit vlerësues për të vendosur se çfarë vlerësimesh nevojiten, ndërsa në rastet urgjente ky takim parapërgatitor mund të bëhet edhe me mënyrë elektronike, telefon e mënyra të tjera të komunikimit të shpejt.
- 4.** Kërkesa për vlerësim e adresuar me shkrim do të dërgohet brenda 8 ditësh nga dita e marrjes së vendimit.
- 5.** Prindërit e fëmijës janë të obliguar që pas marrjes së vendimit, të sjellin fëmijën si dhe dokumentacionin e kërkuar për vlerësim. Nëse prindi apo kujdestari ligjor kundërshton procedurën e vlerësimit, ata duhet gjithsesi ta informojnë Komisionin për mosgadishmërinë e tyre në zbatimin e kërkesës së dërguar nga ana e Komisionit për vlerësim duke parashtruar ankesën e tyre dhe arsyeshmërinë e saj. Ankesa nga ana e prindërve nëse nuk ushtrohet në kohë, atëherë vendimi i Komisionit do të zbatohet brenda 15 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për vlerësim.
- 6.** Komisioni për vlerësim të fëmijës është i obliguar që brenda dy muajsh pas marrjes së kërkesës për vlerësim, të sigurojë dokumentacionin e duhur me të dhënat e nevojshme.
- 7.** Kryesuesi cakton mbajtjen e një takimi të Komisionit për t'i informuar të gjithë anëtarët e nëse paraqitet nevoja edhe shkollën, përfaqësuesit komunal si dhe prindërit apo kujdestarin ligjor të fëmijës për kohën e mbajtjes së këtij takimi.
- 8.** Lajmërimi për takim do të bëhet së paku 10 ditë më parë.
- 9.** Nëse prindërit dëshirojnë të marrin pjesë në takimin e Komisionit, por për shkaqe objektive dhe subjektive nuk mund të vijnë, atëherë takimi mund të shtyhet deri në datën kur prindërit do të kenë mundësi të marrin pjesë.
- 10.** Prindërit kanë të drejtë t'i shqyrtojnë të gjitha dokumentet që i sjell Komisioni si dhe t'i fotokopjojnë sipas nevojës. Njëkohësisht, ata kanë të drejtën të shfrytëzojnë çdo protokol që ka të bëjë me fëmijën e tyre.

11. Komisioni do të mbajë proces të rregullt për çdo takim të mbajtur në të cilin do të evidentohen të gjitha arsyeshmëritë rreth vendimeve të marra.

12. Drejtori komunal i arsimit ku fëmija me nevoja të veçanta caktohet se do të mbajë mësimin, është përgjegjës për zbatimin e vendimit të Komisionit rreth sigurimit të transportit apo kompenzimin e shpenzimeve të nevojshme për bartjen e sigurtë brenda komunës së tyre ose në një komunë tjetër në të cilën është caktuar fëmija që të shkollohet.

13. Kryesuesi i Komisionit ligjërish do të mbikqyrë procesin e zbatimit të vendimeve të cilat i bie Komisioni.

Neni 7

Program i Individualizuar i Arsimimit (PIA)

1. Drejtori i shkollës në të cilën mëson fëmija me nevoja të veçanta, është përgjegjës për kontrollimin e hartimit si dhe zbatimit të PIA-s të fëmijës nga mësimmëdhënësi. Kërkesat e përcaktuara dhe format e aplikimit të PIA-s për nevojat e secilit fëmijë – nxënës veç e veç, janë dhënë në Doracakun për identifikimin, vlerësimin dhe arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta të cilin e ka miratuar dhe aprovuar për përdorim MASHT-i.

2. Krahas rishiqimit të PIA-s, kujdes të veçantë duhet kushtuar realizimit të pikësynimeve (objektivave) rreth avansimit të fëmijës në procesin e mësimnxënies dhe aktiviteteve nga jeta e përditshme.

Neni 8

Rishqyrtimi

1. Komisioni vlerësues duhet t'i shqyrtojë të gjitha vendimet e veta së paku një herë në tri vite. Të gjithë ata që kanë kërkuar të bëhet vlerësimi i FNV nga ana e Komisionit, mund të kërkojnë që rishqyrtimi i vendimeve të bëhet edhe më heret.

2. Procesi i rishqyrtimit do të jetë i ngjashëm me procesin që është përshkruar më lartë, por afati prej tri vitesh mund të shkurtrohet nëse kështu vendos Komisioni.

Neni 9

Financimi

Në bazë të dispozitave të përgjithshme të Ligjit për Menaxhimin e financave publike në Kosovë, MASHT cakton nivelin e pagesës së anëtarëve të Komisionit vlerësues në bazë të punës së kryer.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga ministri.

Agim Veliu, ministër